VENDIM
Nr.38, datë 13.6.2006

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR AKTIVITETIN E IMPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË "WONDER POWER" SHA

Në mbështetje të nenit 13 pika 1 germa dh të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", ndryshuar me ligjin nr.9512, datë 10.04.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe nenet 4 pika 1 germa g, nenit 5 pika 1 dhe nenit 16 pika 3 të "Rregullores për procedurat e licencimit" dhe duke konstatuar mosplotësimin tërësisht të dokumentacionit nga shoqëria lidhur me marrëveshjen paraprake për lejimin e tranzitimit të energjisë elektrike, dhe sa parashikon neni 15 i ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.06.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga "Wonder Power" sh.a. për marrje të licencës të importit të energjisë elektrike, konstatoi se nga tërësia e kërkesave të parashikuara në aktet e mësipërme, "Wonder Power" sh.a. ka plotësuar kryesisht kërkesat, por nuk ka plotësuar kushtin si më poshtë:

Në zbatim të Rregullores për procedurat e licencimit, neni 11 pika 5 dhe paragrafi 2,

- Lidhjen e marrëveshjes paraprake për lejimin e tranzitimit nga sistemet e transmetimit të shteteve nga ku importohet energjia.

Për sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Dhënien e licencës së importit, shoqërisë "Wonder Power" sh.a., me afat 1 vit.
2. Kjo licencë jepet me kusht që brenda 3 muajve nga marrja e vendimit, "Wonder Power" sh.a. të paraqesë në ERE marrëveshjen për lejimin e tranzitimit nga sistemet e transmetimit të shteteve nga ku importohet energjia.
3. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, kjo licencë e humbet fuqinë juridike nëse nuk plotësohet kushti i vendosur për lidhjen e marrëveshjes së tranzitimit nga sistemet e transmetimit të shteteve nga ku importohet energjia.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema